



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 38

Prishtinë, më 10.02.2012, ora 09:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri

Mungoi: Rexhep Selimi dhe Emin Gërbeshi

Përfaqësues nga shteti gjerman: ish Komisioneri i Forcave të Armatosura të Gjermanisë z. Reinhold Robbe shoqëruar nga zëvendës Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë z. Michael Nebelung dhe Matthias Kiesche përfaqësues nga GIZ.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i Rendit të ditës;
2. Takimi i Komisionit me ish Komisionerin e Forcave të Armatosura të Gjermanisë z. Reinhold Robbe;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Takimi i Komisionit me ish- Komisionerin e Forcave të Armatosura të Gjermanisë z. Reinhold Robbe

Kryetari i Komisionit- Prezantoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, dhe përbërjen e tij dhe vazhdoi me prezantimin e rolit të Komisionit për përfaqësuesit e shtetit gjerman. Funkcioni i Komisionit është që të bëjë mbikëqyrjen e Institucioneve që kanë të bëjnë me fushën e sigurisë si dhe të krijojmë një bazë ligjore e cila mundëson funksionimin normal të këtyre institucioneve.

Gjatë këtij mandati si Komision kemi arritur të ofrojmë disa ligje në Parlamentin e Kosovës për tu aprovuar të cilat janë sponsorizuar nga Qeveria e Kosovës si dhe të monitorojmë funksionimin e këtyre institucioneve. Komisioni është i përbërë nga përfaqësuesit e Partive Politike që janë të përfaqësuara në Parlamentin e Kosovës .

Komisioni bënë një punë praktike dhe efektive e cila mundëson një bashkëpunim të mirë mes anëtarëve të Komisionit por edhe me Organizatat që e mbështesin Komisionin siç janë OSCE, NDI, DCAF etj.

Situatat e Sigurisë në Kosovë është pak shqetësuese në Veriun e Kosovës pasi ka ndërhyrje nga shteti serb me instrumente të cilat ndikojnë në jetën e qytetarëve , pengojnë integritetin e pakicës serbe. Kemi një angazhim të Qeverisë së Kosovës dhe të forcave të KFOR-it të komanduara nga Komandandi Erhard Drews të cilat janë munduar të garantojnë integritetin dhe sovranitetin e vendit por duke u përballur me elementet që ndërhyjnë në çështje të sigurisë në Kosovë.

Si Komision jemi të gatshëm që të bashkëpunojmë me Bundestagun gjerman, Komisionin për Siguri, dhe bashkëpunimin e mëtutjeshëm i cili do të ndihmonte shtetin e Kosovës në mënyrë që nga përvojat e shtetit gjerman të mund të krijojmë mekanizma që do të mundësonin efikasitet më të madh në krijimin e një gjendje të sigurisë në Kosovë.

Ish- Komisioneri i Forcave të Armatosura të Gjermanisë z. Reinhold Robbe- Falënderoi Komisionin për interesimin e shprehur për të bashkëpunuar. Për të pasur një pasqyrë të ngjarjeve në Kosovë dje jam takuar me Ambasadorin e Gjermanisë dhe Gjeneralin Drews dhe ekspert të tjerë që e mbështesin shtetin e Kosovës.

Si Komisioner i Mbrojtjes në Bundestag krahas kësaj jam munduar të inicioj bashkëpunime ndërkombëtare që bashkëveprojnë me Bundestagun dhe institucionet e NATO-s, bashkëpunim me aktorët që i mbështesin ushtarët në Kosovë.

Komisioneri i Mbrojtjes në Gjermani ka funksione të veçanta, kjo si rezultat i përvojës historike, funksioni i këtij institucioni është përcaktuar në Kushtetutën e Gjermanisë pas themelimit të ushtrisë gjermane.

Detyrat e Komisionerit janë:

Me mandatin e dhënë nga Parlamenti e kontrollon ushtrinë në fushën e respektimit të drejtave themelore të njeriut, ky kontroll nuk kërkon llogaridhënie apo kontroll financiar. Sigurimi që ushtarët trajtohen mirë dhe të mos keqpërdorën kjo arrihet nga kontrolli parlamentar.

Secili anëtar i ushtrisë gjermane me një Peticion mund ti drejtohet Komisionerit. Para se ankesa të paraqitet tek Komisioneri shqyrtohet nga zyrat përkatëse dhe më pas vendoset a do të kaloj kjo ankesë tek Komisioni në mënyrë që të vërtetohet a ka bazë. Nëse do të ketë keqpërdorim të ankesës nuk do të funksionoj.

Komisioneri bënë një Raport vjetor për Parlamentin për punën e bërë, vizita e trupave gjermane brenda dhe jashtë vendit për të pasur një pasqyrë reale të gjendjes në ushtri, këto vizita janë të pa paralajmëruara.

Komisioneri si mbrojtës i ushtarëve në raport me Parlamentin dhe kontrollin e tij, si vesh i ushtarëve në Parlament.

Funksioni i bashkëpunimit me Median dhe Shoqërinë Civile për gjendjen reale të ushtrisë.

Komisioneri i Mbrojtjes ka një shtab, bashkëpunëtor për kryerjen e funksioneve.

Komisioneri ka detyrë që të mbështes ushtarët në situatat post- traumatike dhe për këtë qëllim është paraparë krijimi i një qendre për trajtimin e ushtarëve.

Kujdesi për familjet e ushtarëve, aspekti social, financiar, kjo është edhe kompetencë e Parlamentit në mënyrë që të drejtat e ushtrisë të respektohen pavarësisht ku ndodhet.

Kryetari i Komisionit- Ne i falënderohemi angazhimeve të shtetit gjerman, Ambasadës gjermane, GIZ-it, KFOR-it gjerman.

Këtë vit bëhet përfundimi i mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës dhe si rezultat i kësaj do të ketë ndryshime kushtetuese dhe prezenca juaj është në momentin e duhur pasi mund të ndikojmë që në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të kemi një organizëm që bënë mbrojtjen e të drejtave dhe mbikëqyrjen demokratike të forcave të armatosura.

Pas përfundimin e mandatit që ka FSK-ja, bashkë me angazhimin që ka pasur me trupat e NATO-s në Kosovë, interesimi është që të jetë një ushtri e cila do të jetë në shërbim të paqes në rajon dhe në bashkëpunim me mekanizmat e tjerë të mbrojtjes.

Më tej Kryetari parashtroi pyetje për ish- Komisionerin gjerman.

Duke qenë se keni qenë Komisioner i forcave të armatosura, a është e domosdoshme që Komisioneri të jetë nga Parlamenti apo mund të jetë një organizatë civile e cila mbikëqyrë të drejtat e ushtarëve?

Nga shumë misione që janë në Kosovë, Gjermania mbetet ndër përkrasit dhe bashkëpunorët më të ngushtë duke ofruar përvoja parlamentare dhe në atë të fushës së sigurisë, FSK-së.

Reinhold Robbe- Komisioneri në Gjermani zgjidhet nga Bundestagu me shumicë absolute. E rëndësishme është të kesh kontakte me të gjithë anëtarët e Parlamentit dhe nga kjo kam arritur të marrë votat edhe të opozitës pasi kjo është në shërbim të ushtrisë, e rëndësishme është neutraliteti i Komisionerit.

Në përgjigjeje të pyetjes se a mund të jetë Komisioneri nga Parlamenti apo jo, nuk është kusht por duke qenë pjesë e Parlamentit mund të ushtroj edhe funksionin e kontrollit ndaj Qeverisë. Nëse Komisioneri do të ishte nga radhët e Shoqërisë Civile do ta kishte të vështirë qasjen në institucione të ndryshme, prandaj mendoj që është shumë e rëndësishme që Komisioneri të zgjidhet nga Parlamenti.

Fatmir Xhelili- Ne jemi ende në fazën e ndërtimit të strukturave të sigurisë së Kosovës, fal ndihmës së miqve që kanë ofruar për ndërtimin e këtyre strukturave dhe edukimin e avancuar dhe bashkëkohorë për qeverisjen e këtyre strukturave. Ofrimi i shpjegimeve nga ana juaj për këtë instrument është i rëndësishëm pasi në këtë vit do të behet vlerësimi i konfiguracionit të strukturave të sigurisë në Kosovë dhe nga ky vlerësim do të identifikohen mangësitë apo mosekzistimi i ndonjë strukture e cila do të implementohet në këtë fazë për ta kompletuar strukturën e segmenteve të sigurisë.

Nga ish-Komisioneri do të kërkoja disa sqarime për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Sigurisë në shtetin tuaj.

U tha që Komisioneri ka detyrë që të mbroj të drejtat themelore të ushtarëve njësi, a është fjala për qasjet e normuara që rregullorja e një njësie ushtarake nuk i ka evidentuar të drejtat, apo ka të bëjë me qasje që nuk janë të përfshira në rregullore të mirësjelljes së eprorëve ndaj ushtarëve në kohën kur njësia është pasive apo gjatë zhvillimit të operacioneve?

A ka gërshetim të strukturave që merren me disiplinën e ushtrisë, siç janë Inspektoratet ushtarake, njësitë hetimore të policisë ushtarake?

Kur fillon të drejtohet tek Komisioneri rastet që konsiderojnë se ka pasur shkelje të drejtash, pasi ka hyrë në fazën e komisioneve disiplinore apo pa kaluar këtë fazë?

A ka pasur raste kur mekanizmat e instrumenteve disiplinore, hetimore janë keqpërdorur nga eprorët?

Faza e reagimit nga Komisioni, konstatimet e nxjerra në raportet vjetore kujt i drejtohen, Ministrisë të Mbrojtjes dhe këto konstatime janë në formën e sugjerimeve apo vlerësimeve?

Reinhold Robbe- Sa i përket çështjeve që i drejtohen Komisionerit janë kryesisht çështje ligjore, p.sh. 2/3 e detyrave të Komisionerit kanë të bëjnë me të drejtat ligjore ushtarëve. Filozofia e udhëheqjes së brendshme, përvoja historike është shumë e rëndësishme, pasi me veshjen e uniformës nuk humben të drejtat e ushtarëve si shtetas. Ushtari mund të bëjë ankesë dhe nuk kërkohet plotësimi i parakushteve. Ankesat mund të bëhen edhe për çështje penale.

Komisioneri ka për detyrë që të mënjanoj rastet që të mos ndodhin në të ardhmen dhe e rëndësishme është që të ketë një institucion të tillë që rastet që konsiderohen shkelje të vihen para Gjyqit dhe të zgjidhen.

Vjollca Krasniqi- Pyetje për z. Reinhold Robbe.

Mënyra e organizimit të këtij sistemi për mbikëqyrjen e ushtarëve dhe ofrimi i ndihmës për ushtarët në raste të veçanta, a ekziston një mekanizëm i tillë edhe për Policinë apo ekzistonë ndonjë formë tjetër e organizimit për këtë çështje?

Reinhold Robbe- Komisioneri ka të bëjë vetëm me ushtarët gjerman dhe jo për nëpunësit civil që punojnë për ushtrinë. Për Policinë është e rëndësishme të kenë një institucion të tillë dhe për këtë ka pasur kërkesë që të kenë një institucion që i mbron, por mendoj që i njëjti institucion mund të themelohet për të gjitha institucionet e Sigurisë

Goran Marinković- Roli i Komisionerit në Gjermani është e rëndësishme dhe mund të konsiderohet e komplikuar. Nga vizitat e bëra nga ana juaj si brenda ashtu edhe jashtë vendit luan një rol shumë të rëndësishëm duke qenë të paanshëm në kryerjen e punëve të tyre sidomos në Kosovë duke kryer punët në mënyrën më të mirë të mundshme dhe për këtë ju falënderoj dhe shpresoj që edhe në të ardhmen të tregoj profesionalizëm të mbrojnë qytetarët e Kosovës dhe të sjellin përvojat më të mira për ne.

Reinhold Robbe- Ju falënderoj për bashkëpunimin dhe ju ftoj për vizitë në Gjermani. GIZ-i do të përgatis plan programin për vizitat në Bundestag, Komisionin e Mbrojtjes, ushtrinë dhe qendrat e trajnimeve pasi në fazën e zhvillimeve në Kosovë kjo vizitë do të ju ndihmonte në krijimin e praktikave më të mira.

Kryetari i Komisionit- Për këtë kemi rënë dakord me përfaqësuesit e Ambasadës së Gjermanisë dhe përfaqësuesit e GIZ-it, për një vizitë të Komisionit në Gjermani sa më shpejt të jetë e mundur, pasi për shkak të ndryshimeve kushtetuese që do të bëhen një përvojë nga kjo fushë nga shteti gjerman do të na shërbente pozitivisht.

Bashkëpunimi me institucionet gjermane do të na ofronte përvoja për funksionimin e Komisionit por edhe për përvojat e zhvillimi të mëtutjeshëm të zhvillimit të FSK-së deri në transformimin e saj në ushtri të Republikës së Kosovës.

Ju falënderoj shumë për sqarimet për mënyrën e funksionimit të këtij mekanizmi, tani kemi një pasqyrë të qartë për rolin dhe rendësin e tij për mbrojtjen e të drejtave të ushtarëve edhe në Kosovë. Ju falënderoj për vizitën dhe së shpejti do të shihemi në shtetin tuaj për të parë më afër funksionimin e këtyre institucioneve

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi